

## GJURMË TË BLEATARISË ILIRO – SHQIPTARE

Është vështirë të përcaktohet koha se kur njeriu nga pylli e solli trungun e parë me bletë pranë kasollës së vet nën përkujdesjen dhe mbrojtjen e tij, periudhë, e cila do të merrej edhe si fillim i bletarisë. Mirëpo, disa gjëra janë të njohura. Pozita gjeografike e popullit shqiptar i ka mundësuar të ketë kushte të favorshme klimatike për kultivimin e bletarisë, duke filluar nga klima subtropike deri tek ajo kontinentale. Kushtet klimatike kanë mundësuar që në këto vise të rriten bimë barishtore dhe drunore mjaltëdhënëse, ku pothuajse tërë vitin ka lulëzim, që është një ndër kushtet themelore për rritje dhe zhvillim të bletarisë.

Kemi shkrime të shumta që dëshmojnë se ilirët kanë qenë bletarë të shkëlqyer dhe mjeshtër të mirë të prodhimit të mjaltit "Aristoteli shkruan se fisi i Taulantëve prodhon një pije të famshme në formën e një vere të fermentuar nga mjalti, që pihej në ritet dioniziake" (Prof as Kristaq Thomo me bashkëpunëtorë - Bletaria – Tiranë 2005).


Nga kjo periudhë kemi edhe dëshmi të tjera si p.sh figura e bletës e skalitur në një masë prej floriri e gjetur në Trebenisht afér qytetit të Ohrit.

Monedhat e qytetit të Butrintit që i takojnë periudhës (168 p.k – 395 pas k.), pos figurave të tjera përmbajnë edhe figura të bletës dhe koshhereve të bletëve (*foto nr.4*).



*Foto nr.4 Monedha dhe stoli me figurë të bletës*

Në kishën e Linit ( afér Pogradecit )që i takon shek IV – VI, në mozaikët e murit të sajë gjemjë figurën e bletës (*foto nr.5*).



*Foto nr.5 Figura e bletës në mozaiket e kishës së Linit afër Pogradecit*

Siapas të dhënavë historike, nga fundi i shkullit VII dhe fillimi i shekullit të VI para erës së re, tregëtia e mjakat dhe e dyllit, që sigurohej nga popullsia Ilire tregëtohej në qyetet e mëdha të shteteve fqinje. Gjatë periudhës së Mesjetës, nga burime të pakta historike, disa nga të cilat të gjetura nga profesor K.Jireqek rezulton, se midis degëve të tjera të blegëtorisë, edhe bletaria kishte marrë një udhë të mbarë. Dallohen për prodhime të mjaltit e dyllit krahinat e luginës së Valbonës, Lezhës dhe një fshat afër Shkodrës, fshati Uliare – sot Livari “(Vladimir Gjerga:Traditat e bletarisë në trevën e Shkodrës, (Buletini informativ i Shoqatës së Bletarisë Shkodrane nr.1 Janar – Mars 2005)

Edhe për Mesjetën kemi të dhëna të fuqishme që tregojnë për një zhvillim të mirë të bletarisë në trevat shqiptare.

Gjatë pushtimit osman është taksa prej një akëshe që i vihej çdo blete. Kështu, në vitin 1476 tatimohen zona e Dibrës, Përmetit, Elbasanit, Mallakastrës, Shkodrës etj.

Në një botim të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë tregohet sasia e madhe e dyllit të eksportuar nga Durrësi (gjatë vitit 1706 janë eksportuar 266 tonë). Kjo sasi kaq e madhe e dyllit e eksportuar tregon për sasinë e madhe të mjaltit të prodhuar në territoret kombëtare, kur dihet se në kushtet e sotme për çdo kv (kvintal) mjaltë merren 4 kg dylli. Edhe në vitin 1806, tregtarët e Shkodrës, përpos mallrave të tjera eksportuan edhe 1500 kv dylli “( Prof.As.Dr.Sadije Bushati – Bletaria në Shkodër – Përfitimet ekonomike të zhvillimit të saj – Mbajtur në Sem.V Ndërkombëtar” Shkodra në Shekuj”).

Për periudhën 1741 – 1802, sipas dokumenteve vjetore, sasia e dyllit të eksportuar nga Shkodra ka qenë 10 84553 libra ose 723,35 kv, ndërsa nga porti i Durrësit ka qenë 224.117 libra ose 1494, 11 kv. Në vite të veçanta, siç ishin: 1748, 1750, 1784, 1796, 1800 dhe 1802, ku konkludohej se kushtet natyrore kanë favorizuar bletarinë, krahas faktorëve të tjerë janë eksportuar çdo vit nga Shkodra 408,5 – 816,3 kv dylli. Këto të dhëna janë marrë nga pasqyra e hartuar në mbështetje të fletëngarkesave të dërguara në Venedik nga konsujt venecian të Durrësit dhe të Shkodrës “(Vladimir Gjerga zooteknik

- Tradita e bletarisë në trevën Shkodrane – Buletin informativ i shoqatës së bletarisë Shkodrane nr.1 Janar Mars 2005).

Edhe krijimtaria popullore është si ditar i një kombi ku pasqyrohen me ndjenja e besnikéri ngjarje historike, ndodhi të ndryshme, gëzime e hidhërimë, hallet e jetës e punët e ditës. Si pjesë e rëndësishme e veprimtarisë njerëzore, edhe bletaria ka hyrë në këngë, valle, fjalë të urta, përralla etj. Kjo ka ndodhur në të gjitha krahinat e trevave Shqiptare dhe ka hyrë edhe në punën shkencore e krijuese të rilindësve tanë e më gjerë. Kështu, rrëth 130 vjet më parë sheh dritën e botimit libri "Bleta shqypëtare", mbledhur e botuar nga Thimi Mitko me 1878. Po kështu, 20 vjet më vonë, me 1898, në Bukuresht del botimi "Mialtë e bletës", mbledhur e botuar nga Visar A. Dodani. Duke ditur vlerat e bletës e të mjaltës, ata e krahasuan krijimtarinë popullore e punën e tyre hulumtuese me bletën.

Edhe në fjalorin e Frang Bardhit të botuar me 1635 zënë vend disa fjalë të urta popullore, ndërmjet të cilave edhe kjo "Mialtët shumë herë ban me lepym gishtat" Kjo tregon se populli ynë qysh atëherë, para 400 vjetësh merrej me bletët dhe dinte vlerat e mjaltës (Jami Kraja - Gjurmë të bletarisë shkodrane në folklore, Buletin informativ i Shoqatës së Bletarisë Shkodrane Nr.4 Prill 2006).

Një e dhënë mjaft e rëndësishme e vitit 1701 është çmimi i miratuar i një oke mjaltë në tregun e vendit që ishte 23 – 25, akshe i krahasuar me çmimet e artikujve të tjera ushqimor të kohës ka qenë 6 – 7 herë më i lartë se sa një okë bukë, 3 herë më e lartë se mishi, 2,5 herë më e lartë se orizi, 3 herë më e lartë se një okë vaj ulliri, 4 herë më i shtrenjtë se një okë ullinj 11 – 12 herë më i lartë se qumështi 2 – 2,5 herë më i lartë se djathi, 8 herë më i lartë se kripa dhe 1,5 herë më i shtrenjtë se sapuni (Vladimir Gjerga – Buletini infomativ i Shoqatës së Bletarëve Shkodran Nr.1 Janar Mars 2005).

Sikurse në tërë botën edhe në trojet shqiptare, deri në shekullin e XX, bletët janë kultivuar në zgjoje trungjesh të bimëve drunërore të gdhendura nga brenda, (foto nr 6)



Foto nr.6 Zgjoje primitive

Siapas shënimëve që kemi në dispozicion, zgjoi i parë modern në Shqipëri u përdor në Delvinë në vitin 1923. Po në këtë vit hapet edhe shkolla e parë teknike në Tiranë. Një

ndër lëndët mësimore ishte edhe lënda e bletës. Ata kishin edhe një park të vogël bletësh në zgjoje moderne. Një prej nxënësve që kreu këtë shkollë ishte edhe Ali Duma, i cili në vitin 1933 formoi bletorën e parë për kultivimin e mëmave në trojet Shqiptare. Mëmat e tij në panairin Ballkanik të mbajtur në Selanik në vitin 1934 fitojnë Medaljen e Argjendtë. Në këtë panair, ky u afirmua si prodhues i mirë i mëmave dhe shumë bletarë nga bota kërkonin mëma prej tij, prandaj me plot të drejtë mund të themi se Ali Duma është themeluesi i parë i bletarisë bashkëkohore në trojet Shqiptare.

Lufta e Dytë Botërore shkatroi çdo gjë, pra shkërrroi edhe bletarinë.

Sipas disa të dhënavë, në Shqipëri janë dëmtuar rreth 14 000 familje bletësh, fatkeqësisht për trojet tjera shqiptare që dhunshëm mbetën jashtë shtetit shqiptar nuk kemi të dhëna të sakta, por edhe këto nuk shpëtuan lehtë.

Pas luftës pushteti socialist në Shqipëri filloj përpjekjet për të zhvilluar dhe inkurajuar bletarinë. Fillojnë të mbahen kurse për bletarë fillon prodhimi i zgjojeve moderne dhe pajisjeve të tjera bletare. Vërehet një rritje e dukshme e numrit të familjeve të bletëve, sepse përpos kooperativave që merreshin me rritjen e bletëve, bletët ishin të lejuara të rriten edhe në mënyrë private. Mirëpo, rendimenti ishte ende i ulët, sillej prej 5 – 8 kg për familje, sepse si në çdo sektor tjetër ekonomik në pushtetin socialist, edhe në bletari nuk u arritën rezultate të lakmueshme.

Megjithatë në vitet e 60 – ta të shekullit të kaluar në Institutin e Lartë Bujqësor në Tiranë vihen themelët e një bletarie shkencore nga i nderuari Prof.doc.Qenan Nuri, i cili bëri edhe studimin e parë të bletës autoktone shqiptare si varietet të racës Carnica.

Një kontribut të veçantë jep edhe krijimi i Stacionit të Bletës dhe Mëndafshit në vitin 1971 i shtrirë në tërë Shqipërinë me rreth 5 000 familje bletë.

Po ashtu, kontribut të pamohueshëm në ngritjen e nivelit të bletarisë dha edhe Shoqata e Bletarëve të Shqipërisë e themeluar në vitin 1960, mirëpo fatkeqësisht për shkaqe politike veprimtaria e saj u shua në vitin 1966.

Duhet cekur se komunikimi në mes të bletarëve shqiptarë jashtë kufijve administrativ të shtetit amë me bletarët e Shqipërisë ishte i pamundur deri pas luftës së fundit.

Mirëpo, edhe gjatë kësaj periudhe 1945 – 2000 me përkushtimin dhe entuziazmin e madh të shumë bletarëve edhe bletaria Kosovare filloj të përparojë.

Me insistimin e disa bletarëve të atëhershëm themelohet Qendra për Zhvillimin dhe Përparimin e Bletarisë së Kosovës, e cila kontributin e vet e jep deri në vitin 1991, kur organet okupuese serbe, si të tërë ekonominë Kosovare e shkatërrojnë edhe këtë.

Në vitin 1978 me iniciativën e Shaip Bejtës, Mirset Halilit, Hamdi Salihut, Selmon Shabanit dhe Sylejman Halilit themelohet Kooperativa e bletarisë „Luboten” në Ferizaj.

Merita të veçanta për zhvillimin e bletarisë për këtë periudhë në Kosovë kanë edhe Dr.Ismail Pireva, prof Zeqir Muçollli, Teki Pula, Fatmir Pula, Tahir Berisha, Refik Gashi, Asim dhe Ibrahim Vula, Avdyl Dabiçaj, Sami Morina, Nezir Vishaj, Zeqë Guslla, Beqir Mulaj etj.

Fatbardhësishët me tranzisionin e sistemit shtetëror në Shqipëri fillon një lulëzim edhe në bletari, kështu që në vitin 1991 riaktivizohet Shoqata e Bletarëve të Shqipërisë në krye me profesorin e nderuar Prof. Assoc Dr.Kristaq Thomo.

Kjo shoqatë filloj botimin e revistës së parë në trojet shqiptare „**Bleta e Shëndeti**” në të cilën trajtohen tema të ndryshme nga bletaria si dhe nëpërmes të saj përcillen edhe të arriturat më bashkëkohore në bletarinë botërore.

Pas Luftës çlirimtare 1998 – 99, në Kosovë organizohen shoqata të bletarëve, pothuaj se në të gjitha komunat e Kosovës, mirëpo rolin më të madh në këtë drejtim e luan Lidhja e Bletarëve të Kosovës në krye me Mr.sci.Haxhi Demukën – kryetar dhe Qerim Ramadani - sekretar.

Në riaktivizimin e këtyre shoqatave, ndihmesë të madhe u jep edhe kryetari i Shoqatës së Rrethit Korçë zot.Gëzim Skerma.

Me iniciativën e Kryetarit të Shoqatës së Bletarëve të Shqipërisë zot.Kristaq Thomo, Lidhjes së Bletarëve të Kosovës dhe Shoqatës së bletarëve të Tetovës revista „**Bleta e Shëndeti**”, fillon të dalë si revistë e përbashkët për të gjitha trojet shqiptare me emrin e ri „**Bleta**”.

Një kontribut të madh në ngritjen e nivelit shkencor kanë dhënë edhe zot.Gëzim Skerma, nënkyetar i Shoqatës së Bletarëve të Shqipërisë, Lejla Shehu, sekretare e Shoqatës së Bletarëve të Shqipërisë, Dr.Pëllumb Aleksi, Dr.Preng Pepa, Hilë Hila, Far. vet. Arben Qafëzezi, Mjek.Vet.Asllan Xhani, Fatmir Mehmetaj, Enver Dyrma, Mirela Saqiralli, Guri Lesjka, Ylli Elezi, Muhamet Skutani, Shuaip Besho – Baçi, Quman Shenaj, Kadri Bulica, Skender Lala etj.

Merita të veçanta në kultivimin dhe seleksionimin e mëmave selektive kanë bletarët e nderuar dhe shumë të respektuar zotërinjtë Pandeli Karapanxho dhe Mehdi Horanlli nga rrathi i Korçës si dhe Vladimir Gjerga – Kryetar i shoqatës së Bletarëve, Shkodër.

Pas luftës së fundit në Kosovë, kontribut të veçantë në zhvillimin e bletarisë kanë dhënë edhe ndërmarrjet private që merren me bletari si „**Bleta**” Prishtinë – Sylejmon Zogiani, **Apimedica**” – Mitrovicë – Zymer Bajraktari „**Gruda**” Pejë – Kujtim Gruda „**Blekos**” Deçan – Arben Vishaj „**Mjalti**” Mitrovicë – Faik Hajdari „**Jego**” Gjakovë – Vezir Agushi „**Apimit – Loriku**” Mitrovicë Lushtë – Abedin Rrustemaj „**Shkendija**” Skenderaj – Avdyl Gucati „**Bletaria Sot**” – Therandë – Naim Gega „**Vjosa**” – Mitrovicë – Muhamedi Sahatçiu „**Bletaria**” – Komogllavë – Ferizaj – Adhurim Halili, „**Apikos**” Pejë, Ferim Mahmutaj, Sh.B „**Luzma**” - Dardanë me kryetarë Halil Dërmakun, Isuf Llullaku – Istog, Hasan Maxharraj – Istog, Bekë Blakaj - Bletar nga Vrella – Istog, Bajrush Shurdhaj – Malishev, Raif Muçolli – Podujevë, Bletarija „**Ensar**” Mitrovicë – Jeton Sadiku, Xhemil Berisha – Krivenik - Hani i Elezit, Fadil Krasniqi – Makovc – Prishtinë, Afrim Berisha Llukar – Prishtinë, Haxhi Bajraktari – Therandë, Dervish Gashi – Therandë, Shefki Muçaj - Therandë etj.